



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

NJOFTIM PËR SHTYP

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural bën më dije se afati i dorëzimit të projekt-propozimeve për grantet konkurruese “Masa për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve”, mbështetur nga Banka Botërore dhe Qeveria Suedeze është shtyrë deri më datë 24 Shtator, 2018.

“Masa për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve” është një masë e re, e cila po zbatohet sipas procedurave IPARD-Like, duke pasur si qëllim realizimin e investimeve, ngritjen e kapaciteteve të Shoqatave të Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave dhe fermerëve të tjerë privatë, dhe rritjen e ndërgjegjësimit të tyre për mundësinë e thithjes së fondeve.

Të gjithë Shoqatat e Përdoruesve të Pyjeve dhe Kullotave, drejtues teknikë dhe aplikantë potencialë, të cilët kanë dorëzuar projekt propozimet teknike për miratim në bashkitë përkatëse, dhe ende nuk kanë marrë aprovimin, kanë afat deri më datë 24 Shtator 2018, për të paraqitur dosjet e tyre pranë zyrave qendrore të AZHBR-së.

Fondi për grantet konkurruese “Masa për Zhvillimin dhe Mbrojtjen e Pyjeve”, thirrja II, 2018 është 2.2 milionë Euro, ku 70% e fondit do të shkojë në favor të aktiviteteve të pyllëzimit për të qenë në koherencë me vizionin e qeverisë për të shtuar sipërfaqe të gjelbra, dhe 30% e fondit për aktivitete si: masat parandaluese ndaj fenomeneve të erozionit, lera uji për bagëtinë, etj. Aplikantët që propozojnë aktivitete pyllëzimi do të kenë më shumë mundësi të shpallen fitues, sepse shihet si një aktivitet veçanërisht i nevojshëm dhe i rendit këta aplikantë në pozita më të favorshme.

Për më shumë informacion në lidhje me thirrjen për aplikime jeni të lutur të shikoni linkun e Manualit Operacional të Granteve. Aty do të gjeni të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për përfitimin e granteve, si dhe në faqen zyrtare të AZHBR-së: <http://azhbr.gov.al/financim/sherbimet-mjedisore/>.